



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2021:055306  
Datë: 30.01.2024  
Numri i dokumentit: 05260075

C.nr.349/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Leart Rexhaj, me bashkëpunëtoren profesionale Shqipe Sejdiu, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.T. nga M., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Sh.A., dhe L.A, avokat nga M., kundër të paditurës K.M-DKA, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar nga marrëdhënia e punës, jashtë seance, me datë 23.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M  
N Ë B A Z Ë T Ë P O H I M I T

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses S.T nga M., NË TËRËSI SI E BAZUAR.

II. DETYROHET e paditura K.M-DKA, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës punës në vlerë 50% të një page bazë t'ia paguaj shumën prej 255.80 euro, me kamatë ligjore 8% nga dita e parashtrimit të padisë dt. 24.03.2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 Euro, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m i

Paditësja S.T nga M., përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi kundër të paditurës K.M-DKA, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit për shpërblim jubilar paditësit për 10 vite përvojë pune në vlerën 50% të një page bazë t'ia paguaj shumën prej 255.80 euro me kamatë ligjore nga dita e parashtrimit të padisë, si dhe shpenzimet e procedurës.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se paditësi me provat e bashkëngjitura padisë ka dëshmuar përvojën për periudhën kohore për të cilën ka kërkuar kompensimin në emër të shpërblimit jubilar. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Gjykata në kuptim të nenit 148 paragrafi 2 të LPK-së, pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurës ka konstatuar se në rastin konkret është fjala për kërkesa me të cilat palët mund të disponojnë lirisht, prandaj në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të LPK-së, gjykata pa shqyrtim të mëtejme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e kamatës gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi konform nenit 449 lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohen përpilimit të padisë në shumë prej 104.00 Euro, dhe taksës për padi në shumë prej 20.00 Euro.

#### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.349/2021, të datës 23.01.2024

Gjyqtari  
Leart Rexhaj

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.